



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

KUVENDI

Komisioni për Çështjet Ligjore, Administratën Publike dhe të Drejtat e Njeriut

Dokument Parlamentar
Tiranë, më 17.04.2019

**RAPORT
PËR
PROJEKTLIGJIN**

“ PËR ORGANIZIMIN DHE FUNKSIONIMIN E POLICISË GJYQËSORE ”

I. Hyrje

Komisioni për Çështjet Ligjore, Administratën Publike dhe të Drejtat e Njeriut, në cilësinë e komisionit përgjegjës, në mbledhjet e datave 9.5.2018, 04.04.2019 dhe 17.04.2019 mori në shqyrtim projektligjin “*Për organizimin dhe funksionimin e policisë gjyqësore,*” propozim i deputetes Vasilika Hysi .

Komisioni për Çështjet Ligjore, Administratën Publike dhe të Drejtat e Njeriut caktoi relatorë për shqyrtimin e këtij projektligji deputeten Eleni Xhina dhe deputetin Alket Hyseni.

Projektligji është paraqitur nga grupi i ekspertëve në Komisionin e Posaçëm të Reformës në Drejtësi, në mbledhjen e datës 16.12.2016, si pjesë e paketës së 27 projektligjeve të hartuara në kuadrin e reformës në drejtësi, pjesë e drejtësisë penale. Bazuar në vendimin 97/2016 të Kuvendit të Shqipërisë, ky projektligj i ka kaluar për shqyrtim Komisionit për Çështjet Ligjore, Administratën Publike dhe të Drejtat e Njeriut.

Në mbledhjet e Komisionit për të diskutuar dhe paraqitur propozime për projektligjin ishin të pranishëm, z. Julian Hodaj Zv/ministër i Ministrisë së Brendshme, Kujtim Luli dhe Alfred Progronati, prokuror si përfaqësues të Prokurorit të Përgjithshëm, përfaqësues të Ministrisë së Drejtësisë, shërbimeve policore, si dhe Idlir Peci dhe Fabian Zhilla, ekspertë të Nivelit të Lartë pranë misionit EURALIUS , përfaqësues të misionit OPDAT, prezencës së OSBE në Shqipëri.

II. BAZA KUSHTETUESE E PROJEKTLIGJIT

Projektligji i paraqitur për shqyrtim është propozim deputeti, sipas përcaktimeve të neneve 78, 81, pika 1 dhe 83, pika 1, të Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë dhe shoqërohet me relacionin përkatës sipas nenit 68 të Rregullores së Kuvendit.

Nga analiza e nenit 81, pika 2, të Kushtetutës dhe përmbajtjes konkrete të këtij projektligji rezulton se fusha që rregullon ky projektligj nuk përfshihet në çështjet që trajton kjo dispozitë kushtetuese, e për pasojë miratimi i këtij projektligji i nënshtrohet rregullit të përgjithshëm për sa i përket shumicës.

III. QËLLIMI DHE RISITË E PROJEKTLIGJIT

Projektligji “*Për organizimin dhe funksionimin e policisë gjyqësore*” ka për qëllim zgjidhjen e problematikave të konstatuara edhe në Dokumentin Analitik të Sistemit të Drejtësisë në organizimin dhe funksionimin e policisë gjyqësore, si (i) dobësimi i lidhjeve të oficerëve të shërbimeve, të caktuar në seksionet e prokurorive, me administratën e origjinës; (ii) ndryshimet në ligjit ekzistues në vitin 2010 me heqjen e procedurës së konkurrimit për oficerët e shërbimeve në seksionet e prokurorisë; (iii) lëvizjet dhe transferimet e shpeshta të tyre; (iv) mos njohja nga prokurorët të organikave të policisë gjyqësore; (v) dobësimi i bashkëpunimit midis prokurorisë dhe policisë gjyqësore; (vi) dhënia e detyrave me karakter administrativ punonjësve të policisë që ushtrojnë dhe funksionin e policisë gjyqësore kanë cenuar stabilitetin në punën e policisë gjyqësore si dhe vetë cilësinë e hetimeve.

Dokumenti Strategjik për Reformën në Sistemin e Drejtësisë ka parashikuar, ndër të tjera, si objektiv të reformës, riorganizimin e policisë gjyqësore, duke forcuar dhe përmirësuar statusin e saj, profesionalizmin, përgjegjshmërinë, llogaridhënien dhe eficiencën.

Në kuadrin e këtij objektiv, Plan Veprimi i Reformës në Sistemin e Drejtësisë ka parashikuar hartimin e një ligji të ri “*Për organizimin dhe funksionimin e Policisë Gjyqësore*”, me qëllim:

- riorganizimin strukturor dhe funksional të policisë gjyqësore, duke synuar rritjen e përgjegjësisë së saj në zhvillimin e hetimeve proaktive, profesionale dhe efikase në luftën kundër kriminalitetit, nën drejtimin dhe kontrollin e prokurorit;
- qartësimin e roleve të Prokurorit dhe Policisë Gjyqësore, duke e kthyer prokurorin në një mbikëqyrës të hetimit penal, dhe duke ia deleguar kompetencat e hetimit dhe një pjesë të veprimeve procedurale gjatë hetimit Policisë Gjyqësore;
- rregullimin e raportit të numrit të prokurorëve me numrin e oficerëve të policisë gjyqësore sipas organizimit të brendshëm të vetë prokurorisë dhe ngarkesës së çështjeve dhe problematikave të kriminalitetit në zona të caktuara;
- forcimin e kriterëve profesionale, etike e morale në rekrutimin dhe promovimin e oficerëve të policisë gjyqësore, duke synuar krijimin një sistemi që mundëson arsimim të përshtatshëm profesional, zhvillimin e një karriere të qëndrueshme si dhe trajnimin nevojën e domosdoshme të trajnimit fillestar dhe të vazhduar të policisë gjyqësore, kualifikimin vazhduar të tyre;
- parashikimin e mekanizmave për tërheqjen e kontributit të specialistëve dhe ekspertëve teknikë pranë zyrave të prokurorisë;
- garantimin e burimeve të nevojshme materiale, financiare dhe njerëzore për Policinë Gjyqësore, duke synuar gjithashtu thithjen e ekspertëve të fushave të ndryshme pranë kësaj strukture;

- rindërtimin e rregullave që synojnë stabilitetin në detyrë të shërbimeve të policisë gjyqësore, sidomos të atyre të specializuara në sektorë të posaçëm të luftës ndaj krimit, duke vendosur një kontroll më mbi transferimet;
- kërkon të disiplinojë mbrojtjen e hetimeve, duke vendosur rregulla përsa i takon raportimit të rezultatit të hetimeve vetëm para prokurorit kompetent;
- vendosjen e rregullave të tilla që oficerët që kryejnë funksione gjyqësore të kenë kohën e nevojshme për t'u fokusuar tek ato, pa lejuar që ata të ngarkohen me detyra të tjera që u kufizojnë kohën dhe energjitë që nevojiten për të kryer hetim;
- gjetjen e mekanizmave që të nxitin punën e përbashkët, me krijimin e grupeve të hetimit me oficerë të seksioneve dhe të shërbimeve, sidomos në rastin e hetimeve proaktive; duke theksuar rolin e prokurorit që drejton hetimet.

IV. PËRMBATJA E PROJEKTLIGJIT

Projektligji i ripunuar nga grupi i punës, përbëhet prej IX krerësh si më poshtë:

Kreu I, përcakton objektin e ligjit, parimet e ushtrimit të veprimtarisë së policisë gjyqësore dhe subjektet që ushtrojnë këto funksione.

Kreu II, përcakton funksionet e policisë gjyqësore, veprimet me iniciativë në rastet e veçanta, mbikëqyrjen dhe varësinë funksionale në ushtrimin e funksioneve, duke përcaktuar qartë kush janë funksionet e policisë gjyqësore, mbikëqyrjen dhe varësinë e policisë gjyqësore si dhe ruajtjen e sekretit hetimor.

Kreu III, parashikon krijimin e Komisionit të Policisë Gjyqësore, i cili është një organ kolegjal i përbërë nga 5 anëtarë, duke përcaktuar edhe mandatin e kryetarit dhe anëtarëve të komisionit. Gjithashtu në këtë kre përcaktohen kompetencat e Komisionit si dhe mënyra e organizimit dhe funksionimit të tij.

Kreu IV, pasqyron organizimin e policisë gjyqësore, kush janë seksionet dhe shërbimet e policisë gjyqësore, si organizohen shërbimet dhe seksionet dhe cilat janë kriteret e përzgjedhjes së oficerëve të shërbimeve dhe atyre të seksioneve të policisë gjyqësore dhe procedura e ndjekur. Gjithashtu, ky kre përmban dispozita në lidhje me heqjen dorë, zëvendësimin, ngritjen në detyrë, komandimin, transferimin si dhe shkarkimin e lirimin e tyre oficerëve të policisë gjyqësore.

Kreu V, përcakton veprimtarinë hetimore të policisë gjyqësore, bën një ndarje midis veprimeve hetimore që kryhen nga shërbimet e policisë gjyqësore dhe atyre veprimeve hetimore që kryhen nga seksionet e policisë gjyqësore. Gjithashtu parashikon edhe mundësin e kryerjes së veprimeve hetimore si nga shërbimet ashtu dhe nga seksionet, kjo në varësi të natyrës dhe kompleksitetit të çështjes.

Kreu VI, parashikon rregulla në lidhje me trajnimin fillestar dhe vazhdues profesional të oficerëve të policisë gjyqësore i cili realizohet nëpërmjet bashkëpunimit të Komisionit të

Policisë Gjyqësore me Prokurorin e Përgjithshëm, Akademinë e Sigurisë ose me institucionet publike arsimore. Në këtë krah përcaktohen mënyra e vlerësimit e rezultateve në punë për oficerët e policisë gjyqësore.

Kreu VII, rregullon trajtimin financiar të policisë gjyqësore, duke përcaktuar pagën e tyre, shpërblimet dhe përfitime të tjera.

Kreu VIII, përcakton rregullat e përgjithshme të përgjegjësisë disiplinore të oficerëve të policisë gjyqësore, duke përcaktuar cilat janë shkeljet, masat disiplinore dhe procedurën disiplinore si dhe organin kompetent që ka të drejtën e fillimit të procedimit penal duke i dhënë mundësi oficerit apo agjentit të policisë gjyqësore të mund të ankohet në Gjykatën Administrative.

Kreu IX, dispozitat kalimtare, parashikon detyrimin e Këshillit të Ministrave dhe Komisionit të Policisë Gjyqësore për të nxjerrë aktet nënligjore në zbatim të këtij ligji dhe hyrjen në fuqi të këtij ligji.

V. PROCESI I HARTIMIT DHE KONSULTIMIT TË PROJEKTLIGJIT

Për përgatitjen e këtij projektligji u ngrit grupi i punës i përbërë nga ekspertë të nivelit të lartë dhe ekspertë të sekretariatit teknik si dhe grupi i konsultimeve Think Tank me përfaqësues nga Prokuroria e Përgjithshme, Ministria e Brendshme, dhe përfaqësues të seksioneve të policisë gjyqësore nën asistencën e misionit EURALIUS e OPDAT.

Në fillim të procesit të draftimit të këtij projektligji është përgatitur një vlerësim paraprak ku është parashikuar një përmbledhje e ndërhyrjeve të propozuara, arsyetimin e nevojshmërisë së këtyre ndërhyrjeve dhe standardet ku do të mbështeten. Ekspertet e nivelit të lartë dhe grupi i konsultimeve Think Tank kanë zhvilluar disa takime, ku janë diskutuar ndryshimet e propozuara në projektligjin për policinë gjyqësore.

Me kalimin e projektligjit “Për Organizimin dhe Funksionimin e Policisë Gjyqësore” në Komisionin e Ligjeve dhe caktimi i relatorëve për shqyrtimin e tij, u ngrit një grup pune për të reflektuar në projektligj të gjitha opinionet e ardhura nga institucione apo grupe interesi për projektligjin. Reflektimi i opinioneve të ardhura pranë Komisionit të Ligjeve, relatorët ngritën grupin e punës me përfaqësues të Prokurorisë së Përgjithshme, Zv/ministrin e Ministrisë së Brendshme, oficer të policisë gjyqësore të seksioneve në Prokurorinë e Përgjithshme si dhe ekspertë të misionit Euralius.

Në funksion të transparencës dhe gjithpërfshirjes, projektligji i ripunua nga relatorët dhe grupi i punës është përcjellë nga Komisioni i Ligjeve për konsultim dhe mendim në Ministrinë e Drejtësisë, Ministrinë e Mbrojtjes, Ministrinë e Brendshme, Prokurorinë e Përgjithshme Ministrinë e Financave, Drejtorinë e Përgjithshme të Tatimeve, Drejtorinë e Përgjithshme të Doganave, si dhe OSBE, OPDAT etj si dhe ka organizuar tryeza konsultimi.

Sugjerimet e sjella për projektligjin në adresë të Komisionit u morën në shqyrtim nga grupi pune dhe relatorët dhe u reflektua në dispozitat e projektligjit.

VI. VLERËSIMI I LIGJSHMËRISË KUSHTETUESE DHE HARMONIZIMI ME LEGJISLACIONIN NË FUQI.

Projektligji nuk vjen ndesh me ndonjë dispozitë të Kushtetutës dhe është në përputhje me përcaktimet në Kodin e Procedurës Penale, me legjislacionin në fuqi për organizimin dhe funksionimin e institucioneve për të luftuar korrupsionin dhe krimin e organizuar ashtu dhe me legjislacionin në fuqi që përcakton mënyrën e organizimit dhe funksionimit të shërbimeve të policisë gjyqësore në Policinë e Shtetit, Ushtarake apo me institucionet e tjera shtetërore të cilëve me ligj u njihen funksione të policisë gjyqësore.

VII. ÇËSHTJET E DISKUTUARA NË KOMISION

Gjatë prezantimit të projektligjit në parim, propozuesi dhe relatori u fokusuan tek domosdoshmëria e hartimit të projektligjit “Për Organizimin dhe funksionimin e Policisë Gjyqësore” me qëllim:

- adresimin e problematikave të evidentuara në analizën e sistemit të drejtësisë;
- përcaktimin e rregullave dhe parimet e përgjithshme në lidhje me organizimin e Policisë Gjyqësore, veprimtarinë e tyre hetimore, statusin e oficerëve të policisë gjyqësore, raportet me prokurorinë dhe institucionet shtetërore ku bëjnë pjesë.

Relatori deklaroi se jemi përpjekur për të bërë më të mirën duke bërë diskutime dhe mendime të ndryshme në shumë aspekte po jemi munduar për të paraqitur një projektligj konsensual. Duke i kushtuar rëndësi këtij ligji si një hallkë e rëndësishme e suksesit të hetimit penal dhe kemi mundësuar për të patur një ligj për të garantuar një hetim rezultativ dhe për të mundësuar që reforma në drejtësi të ketë rezultatet e saj gjatë hetimit.

Në vazhdim të diskutimit në Komision, në fillim të shqyrtimit nen për nen të kësaj nisme ligjore, relatorët sqaruan anëtarët e Komisionit se në dakordësi me propozuesin, është konkluduar në një variant të unifikuar, të propozimeve të nismëtarit dhe relatorit, duke qenë se pas procesit të konsultimit u bë e nevojshme propozimi i ndryshimeve në dispozitat e variantit të depozituar si dhe propozimi i disa neneve të reja, me qëllim përmirësimin e mëtejshëm të nismës.

Një vëmendje e veçantë i është kushtuar ngritjes të Komisionit të Policisë Gjyqësore ,përbërjes, mënyrës së funksionimit dhe kompetencave që i përcaktohen nga ky projektligj.

Gjatë shqyrtimit të këtij projektligji në Komision, diskutimi u fokusua në këto çështje kryesore:

➤ Ngritjen dhe funksionimin e Komisionit të Policisë Gjyqësore

Projektligji i depozituar dhe i miratuar në Komisionin Ligjeve parashikon ngritjen e Komisionit të Policisë Gjyqësore si një organ kolegjal i përbërë nga 5 anëtarë . Anëtarësia e Komisionit të Policisë Gjyqësore, u vlerësua që ajo të ishte gjithë përfshirëse me përfaqësues

nga policia gjyqësore e seksioneve, nga shërbimet e policisë gjyqësore në strukturën hetimore në Policinë e Shtetit, drejtuesi i strukturës hetimore të shërbimeve në Policinë e Shtetit dhe me rotacion çdo dy vjet përfaqësues nga shërbimet e tjera të policisë gjyqësore, të institucioneve shtetërore të propozuar ose nga Drejtori i Përgjithshëm i Tatimeve ose Drejtori i Përgjithshëm i Doganave.

Kryetar i këtij Komisioni është prokurori i caktuar nga Prokurori i Përgjithshëm nga prokurorët e seksionit në Prokurorinë e Përgjithshme.

Projektligji i ngarkon këtij Komisioni kompetenca si:

- a) Përcakton numrin e përgjithshëm të oficerëve të policisë gjyqësore të seksioneve dhe shërbimeve, në bashkëpunim me Prokurorin e Përgjithshëm dhe Ministrat përgjegjës të cilët kanë në varësi shërbimet e policisë gjyqësore.
- b) Emëron, ngre në detyrë, transferon, komandon, oficerët e policisë gjyqësore të seksioneve, me propozim të Prokurorit të Përgjithshëm;
- c) Miraton transferimin dhe komandimin e oficerëve të policisë gjyqësore të shërbimeve, me propozim të titullarit të institucionit shtetëror ku ata bëjnë pjesë;
- ç) Shqyrton kërkesat për procedim disiplinor ndaj oficerëve të policisë gjyqësore sipas parashikimeve të këtij ligji;
- d) Vlerëson rezultatet e punës dhe integritetin e oficerëve të policisë gjyqësore;
- dh) Përcakton rregullat për organizimin e një trajnimi fillestar për hetimin, sipas neneve 16 dhe 17 të këtij ligji, në bashkëpunim me Prokurorin e Përgjithshëm, Akademinë e Sigurisë ose institucionet publike arsimore, të ngarkuara me ligj për trajnim profesional.

Kompetencat që projektligji i ka dhënë Komisionit të Policisë Gjyqësore do të ndikojnë:

- në rregullimin e raportit të numrit të prokurorëve me numrin e oficerëve të policisë gjyqësore të seksioneve sipas organizimit të brendshëm të vetë prokurorisë dhe të numrit të përgjithshëm të policisë gjyqësore të shërbimeve bazuar në ngarkesën e çështjeve, si dhe problematikave të kriminalitetit në zona të caktuara.

- krijon mundësi për përzgjedhje më objektive dhe me transparencë në emërimin, apo komandimin e oficerëve të policisë gjyqësore të seksioneve.

- Zgjidhë një nga problematikat e konstatuara gjatë hetimeve paraprake nga shërbimet e policive gjyqësore, ku transferimi i oficerëve të policisë gjyqësore nga drejtuesit e shërbimeve bëhej pa dijeninë e prokurorit duke krijuar probleme dhe zvarritje të hetimeve. Projektligji duke dhënë Komisionit si kompetencë miratimin e transferimit të oficerëve të policisë gjyqësore të seksioneve dhe shërbimeve, kur ekzistojnë kushtet e parashikuara në nenin 22 të këtij projektligji, krijon stabilitet në detyrë të shërbimeve të policisë gjyqësore, sidomos të atyre të specializuara në sektorë të posaçëm të luftës ndaj krimit, si dhe frenon fenomenin e zvarritjes së hetimeve për shkak të transferimeve pa dijeninë e prokurorit.

- jep zgjidhje problematikave të konstatuara në shqyrtimin e procedimit disiplinor ndaj oficerëve të policisë gjyqësore, kur prokurori kërkonte procedim disiplinor për rastet e zvarritjes së pajustificuar dhe të përsëritur nga oficerët e policisë gjyqësore, rastet e

mungesave të pajustificuara dhe të vijueshme si dhe të rasteve kur nuk e informonte prokurorin për ecurinë e hetimeve etj.

-zgjidh problematikat e konstatuara në organizimin dhe trajtimin fillestar dhe vazhdues të oficerëve të policisë gjyqësore, ku Komisioni i Policisë Gjyqësore do ta realizojë në bashkëpunim me Prokurorin e Përgjithshëm ,Akademinë e Sigurisë dhe institucionet publike arsimore.

Në Komision u diskutua në lidhje me mandatin e anëtarëve të Komisionit , Pas diskutimeve edhe pse Komisioni i Sigurisë Kombëtare rekomandonte që mandati i anëtarëve të Komisionit të Policisë Gjyqësore të ishte 4 apo 5vjet, deputete vendosën që mandati i anëtarëve të Komisionit të policisë Gjyqësore të jetë 2 vjet me të drejtë përsëritje.

➤ Organizimi i Shërbimet e Policisë Gjyqësore në Policinë e Shtetit në strukturën hetimore.

Projektligji në disa nene të tij,përdoret termin “strukturën hetimore”. Në komision eksperti i Euralius sqaroi vendosjen në pikën 6 të nenin 2 dhe më pas në dispozitat e këtij projektligji togfjalëshin “strukturë hetimore”Sipas ekspertit, grupi punës nisur nga problematikat e konstatuara në hetim, ku oficerët lëvizin në çdo moment të hetimit pa kontaktuar me prokurorin duke çuar në mjaft raste zvarritje të hetimit apo duke dëmtuar hetimin penal,sjell nevojën që të krijohet një strukturë hetimore brenda shërbimeve në Policinë e Shtetit. Përdorimi i termit ‘strukturë hetimore “ nuk nënkupton se do të krijohet një strukturë qendrore apo strukturë vendore. Në projektligj është përdorur termi “strukturë hetimore” i cili është një term fleksibël që i lejon policisë së shtetit bazuar në ligjin organik apo me akte nënligjore të ketë një trup oficerësh të policisë gjyqësore që të merren me hetimin. Një arsye tjetër është që prokurori në çdo prokurori të juridiksionit të përgjithshëm të ketë në dispozicion shërbimet e policisë gjyqësore të Policisë së Shtetit, shërbim që do të jetë pjesë e kësaj strukture fleksibël brenda policisë së shtetit. Zv/ ministri i Ministrisë së Brendshme si pjesë e grupit të punës ka dhënë dakordësinë e institucionit për organizimin e shërbimeve të Policisë së Shtetit në strukturën hetimore .

Deputetët në diskutimet e tyre mbështetën opinionin e ekspertit duke miratuar formulimet në projektligj.

➤ Agjentët e Policisë Gjyqësore

Në komision u diskutua në lidhje me agjentët e policisë gjyqësore si pjesë e shërbimeve në Policinë e Shtetit.

Diskutimet u fokusuan në përmbajtjen e pikës 6 të nenit 2 të projektligjit , ku jepet përkufizimi i strukturës hetimore si pjesë e strukturës së përgjithshme të Policisë së Shtetit të përfshiheshin dhe agjentët e policisë gjyqësore.

Relatorët e projektligjit në diskutimin e tyre theksuan se projektligji trajton aspektin procedural të policisë gjyqësore, dhe jo në tërësi veprimtarinë policore, aspekti organizativ i cili

rregullohet nga ligji i Policisë së Shtetit Përcaktimi në pikën 6 të nenit 2 të projektligjit, nuk përjashton agjentët si pjesë e strukturës hetimore. Ata kryejnë veprimet e para të domosdoshme si dhe detyra të caktuara nga oficerët e policisë gjyqësore po në aspektin procedural është oficeri i policisë gjyqësore që kryen funksione hetimore. Agjentet e policisë gjyqësore si dhe të gjitha shërbimet e tjera në Policinë e Shtetit janë në funksion të kësaj strukture. Një ligj për Jo për tërësinë e veprimtarisë policore.

Kryetari i Komisionit të Ligjeve në diskutimin e tij theksoi se projektligji nuk ka qëllim zhvillimin e koncepteve të Kodit të Procedurës Penale i cili në nenet 30, 31, 32, e ka përcaktuar qartë funksionet e policisë gjyqësore dhe kush janë shërbimet e policisë gjyqësore.

Deputetët miratuan pikën 6 të nenit 2 sipas përcaktimit në draftin e grupit të punës.

➤ Papajtueshmëria etike

Papajtueshmëria etike është vendosur për të zgjidhur ato raste ku Kodi i Procedurës Penale nuk e detyron oficerin e policisë gjyqësore të japë dorëheqje, si në rastin ku një nga familjarët jo të afërt ka probleme penale, ka lidhje e papërshtatshme shoqërore, rrethi i tij shoqërori papërshtatshëm apo marrëdhënie me një person të papërshtatshëm kur këto lidhje çenojnë objektivitetin në kryerjen e hetime ose në rastet e konfliktit të interesit për shkak të këtyre lidhjeve.

Relatori i projektligjit z.Hyseni, në diskutimin e tij analizoi pse në pikën 5 të nenit 2 të projektligjit jepet përkufizimi i” papajtueshmërisë etike” dhe në nenin 22 të projektligjit parashikohet si një rast për transferimi e oficerit të policisë gjyqësore. Në projektligj ka qene koncepti i papajtueshmërisë ambientale, koncept i cila është shfuqizuar nga Gjykata Kushtetuese. Papajtueshmëria etike lidhet me ato raste të paparashikuara në Kodin Procedurës Penale po që në vetvete kanë problematika. Në rastin e një të afërmi që nuk futet në rrethin familjar të parashikuar nga Kodi i Procedurës Penale, po mund të jetë një shkak i pastër i papajtueshmërisë etike duke e bërë oficerin e policisë gjyqësore të mos jetë i lirë në vendimmarrjen e tij për shkak të konfliktit të interesit, ashtu siç mund të jete një lidhje shoqërore e papërshtatshme .Në rastin e konceptit të papajtueshmërisë etike, projektligji i përmbahet synimit që ka reforma në drejtësi për një oficer të policisë gjyqësore me integritet. Provueshmëria e papajtueshmërisë ambientale është rast pas rasti kur provohet se ka një lidhje të papërshtatshme jashtë rrethit familjar që parashikon Kodi i Procedurës Penale.

Gjatë diskutimit deputetët dhe të ftuarit propozuan të hiqet togfjalëshi “për shkak të raporteve që burojnë nga gjendja familjare “ me arsyetimin se është parashikuar ne Kodin e Procedurës Penale.

➤ Komandimi dhe transferimi i oficerit të Policisë Gjyqësore

Në nenin 21 të projektligjit përcaktohen rastet që për nevojat e kryerjes së hetimeve të një çështje të mund të komandojë oficerët e policisë gjyqësore nga një seksion apo shërbim në një seksion apo shërbim tjetër bazuar në propozimin e Prokurori i përgjithshëm për oficerët e policisë gjyqësore të seksioneve ose titullari i institucionit shtetëror përkatës për oficerët e shërbimeve.

Në nenin 22 të projektligjit përcaktohen rastet e transferimit, kush e propozon si dhe afatin brenda të cilës komisioni do vendos mbi pranimin ose jo të transferimit.

Në komision, deputetët diskutuan për rastin kur transferimi kërkohet në kushtet kur oficerit të policisë gjyqësore ndodhet para një situatë reale të rrezikut ndaj jetës dhe shëndetit ose të familjes së tij, sa duhet të jetë afati që Komisioni duhet të shprehet. Komisioni i Sigurisë në raportin e tij, i rekomandonte Komisionit të Ligjeve si komision përgjegjës riformulimin e pikës 4 të këtij neni. *”Në rastet kur ekziston një situatë reale riziku ndaj jetës dhe shëndetit të oficerit të policisë gjyqësore ose familjes së tij, Komisioni i Policisë Gjyqësore të vendosë brenda 48 orëve nga marrja dijeni e propozimit.”*

Deputet në Komisionin e Ligjeve dhe duke analizuar faktin që ky komision është një komision “Ad Hoc”, nuk mund të caktojme afate 48 orë, vendosën të miratonin pikën 4 të nenin 22 të projektligjit sipas draftit të paraqitur nga grupi i punës.

➤ Pagat dhe shpërblimet e oficerëve të policisë gjyqësore .

Projektligji ‘Për organizimin dhe funksionimin e Policisë Gjyqësore “ në përcaktimin e pagës për oficerët e policisë gjyqësore të seksioneve i është referuar ndryshimeve që ju bë nivelit të pagave në ligjin nr. 96/2016 “Për statusin e gjyqtarit dhe prokurorit “

Në lidhje me këtë çështje komisionit i kanë ardhur opinione nga Prokuroria e Përgjithshme, oficeret e policisë gjyqësore të seksioneve në prokuroritë e juridiksionit të përgjithshëm si dhe Ministria e Ekonomisë dhe Financave.

Përfaqësuesi i Prokurorisë së Përgjithshme dhe oficeret e policisë gjyqësore të seksioneve kërkuar që paga e tyre të jetë 70% e pagës bruto fillestare e prokurorit duke argumentuar se ligji në fuqi “ Për organizimin e funksionimin e Policisë Gjyqësore” ka përcaktuar se paga e oficerit është 70% e pagës së prokurorit dhe më hyrjen në fuqi në 1 janar 2019 të sistemit të ri të pagave për prokurorët, oficeret e policisë gjyqësore kanë marrë 70% të pagës bruto fillestare të prokurorit. Pra është një e drejtë e fituar e cila nuk mund të ndryshojë me miratimin e ligjit të ri për policinë gjyqësore.

Ministria e Ekonomisë dhe Financave në shkresën drejtuar Komisionit të Ligjeve, është shprehur se nisur nga kostoja financiare që shkakton rritja e pagave të oficerëve të policisë gjyqësore të seksioneve pranë prokurorive të juridiksionit të përgjithshëm dhe oficerëve të policisë gjyqësore të Byrosë Kombëtare të Hetimit, paga e tyre të jetë 50% e pagës bruto

fillestare e prokurorit sipas përcaktimit të kësaj page në ligjin Për statusin e gjyqtarit dhe prokurorit“

Në përcaktimin e pagës dhe përfitimeve të tjera financiare të oficerëve të policisë gjyqësore, relatorët, vlerësuan rolin dhe funksionet që i ngarkon Kodi i Procedurës Penale oficerëve të policisë gjyqësore në kryerjen e veprimeve hetimore.

Duke vlerësuar shqetësimin parimor të ngritur për ruajtjen e hierarkisë së piramidës së pagave, Komisioni i Ligjeve, me qëllim adresimin e objektivave të evidentuara në Strategjinë e Reformës në Sistemin e Drejtësisë, nisur nga funksionet e oficerëve të policisë gjyqësore të seksioneve dhe të Byrosë Kombëtare të Hetimit, vendosi të miratojë që ***Paga e oficerit të Policisë Gjyqësore, të seksioneve të prokurorive pranë gjykatave të shkallës së parë të juridiksionit të përgjithshëm dhe të Prokurorisë së Përgjithshme është e barabartë me 60 për qind të pagës bruto fillestare të prokurorit që ushtron funksionet pranë tyre sipas përcaktimeve në legjislacionin në fuqi për statusin e gjyqtarit dhe prokurorit.***”

VIII . PËRMBLEDHJE E NDRYSHIMEVE TË MIRATUARA NË KOMISION

Projektligjit “Për organizimin dhe funksionimin e Policisë Gjyqësore të paraqitur nga grupi i punës, bazuar në sugjerimin e Komisionit të Sigurisë Kombëtare, Prokurorisë së Përgjithshme, OSBE, OPDAT, Ministria e Mbrojtjes, dhe diskutimeve të ftuarve dhe deputeteve të Komisionit të Ligjeve ju bënë disa ndryshime si më poshtë vijon:

- Komisioni saktësoi kuptimin e termit” papajtueshmëri etike” duke e riformuluar pikën 5 neni 2 të projektligjit *“Papajtueshmëri etike“ është një situatë kur oficeri i policisë gjyqësore pengohet të ushtrojë me objektivitet funksionet e tij në një zyrë të caktuar, nga lidhjet e papërshtatshme shoqërore ose nga konflikti i interesit “.*
- Gjithashtu u pranua sugjerimi i Ministrisë së Mbrojtjes për riformulim e pikën 2 të nenit 2 të projektligjit, sugjerimi i Ministrisë së Brendshme për riformulimin e pikës 6 të nenit 2, sugjerimi i Prokurorisë së Përgjithshme për riformulimin e pikës 7 të nenit 2 të projektligjit të cilat janë pasqyruar në përmbajtjen e nenit 2 në draftin integral të projektligjit .
- Riformulimin e nenit 4 në lidhje me subjektet që ushtrojnë funksionet e policisë gjyqësore sipas përcaktimeve në Kodin e Procedurës Penale dhe sugjerimit të Komisionit të Sigurisë.
- Komisioni pranoi formulim e bërë nga Komisioni i Sigurisë për shkronjën “a” dhe “c” të pikës 1 neni 5 të projektligjit.

- U riformulua neni 6 i projektligjit sipas sugjerimeve të Prokurorisë së Përgjithshme dhe Komisionit të Sigurisë.
- Nisur nga propozimet e Prokurorisë së Përgjithshme për shkronjë”a” të pikës 1, pikës 3 dhe pikën 4 neni 9 të projektligjit, u përcaktua institucioni që cakton anëtarin prokuror .
- Në riformulimin e shkronjës” d “neni 10 dhe riformulimin e pikës 2 të nenit 11 të projektligjit, komisioni mori në konsideratë propozimin e OSBE-së .
- U riformulua shkronja “c” dhe” d” neni 16 i projektligjit sipas sugjerimeve të Komisionit të Sigurisë si dhe u riformulua pika 2 e këtij neni sipas sugjerimeve të Ministrisë së Brendshme duke përjashtuar si kriter të përzgjedhjes të oficerit e policisë gjyqësore të Policisë së Shtetit shkronjën ‘a”të pikës 1 të këtij neni në të cilin thuhet “*të ketë përvojë 5 vjet punë në institucionin e emërtesës siç është për shërbimet e tjera të policisë gjyqësore*” .
- Pika 3 neni18 i projektligjit,u riformulua sipas rekomandimeve të OSBE-së me qëllim që rregullat për organizimin dhe procedurat e konkurrimit dhe emërimit të oficerëve të policisë gjyqësore të seksioneve të përcaktohen me propozim të Komisionit dhe miratim të Prokurorit të Përgjithshëm.
- Komisioni pas diskutimeve duke marrë në konsideratë sugjerimin e Prokurorisë së Përgjithshme, të Komisionit të Sigurisë, të oficerëve të policisë gjyqësore të seksioneve si dhe të Ministrisë së Ekonomisë dhe Financave, si dhe duke vlerësuar funksionin e policisë gjyqësore në kryerjen e veprimeve hetimore riformuloi pikën 1 të nenit 30 të projektligjit Me përcaktimin e pagës së oficerit të policisë gjyqësore të seksioneve të juridiksionit të përgjithshëm në masën 60% të pagës bruto fillestare të prokurorit sipas përcaktimeve në ligjin 96/2016 ‘Statusi i gjyqtarit dhe prokurorit’, projektligji synon që paga e kësaj kategori të jetë në harmoni me rolin dhe funksionin e tyre.
- U riformulua pika 3 neni 31i projektligjit sipas rekomandimeve të OPDAT me qëllim që pajisja me armë e oficerëve të policisë gjyqësore të seksioneve , Byrosë Kombëtare të Hetimit duke e harmonizuar me legjisllacionin në fuqi për përdorimin e armëve të zjarrit.
- Në funksion të parimit të sigurisë juridike, projektligji parashikon dispozitat kalimtare për të siguruar vijimësinë normale të funksionimit të policisë gjyqësore të seksioneve të juridiksionit të përgjithshëm dhe oficerëve të policisë gjyqësore në Prokurorinë e Krimeve të Renda.

VII. PËRFUNDIME

Në përfundim, Komisioni për Çështjet Ligjore, Administratën Publike dhe të Drejtat e Njeriut, konstatoi se :

- Në aspektin ligjor, projektligji është në përputhje me Kushtetutën dhe legjislacionin në fuqi;
- Në aspektin procedural, projektligji është paraqitur në përputhje me Rregulloren e Kuvendit;

dhe pasi e shqyrtoi projektligjin në parim, nen për nen dhe në tërësi, me shumicën e votave të anëtarëve të pranishëm miratoi projektligjin, sipas tekstit integral bashkëlidhur këtij raporti.

RELATOR

KRYETAR

ALKET HYSENI

ULSI MANJA

ELENA XHINA



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

Kuvendi

PROJEKTLIGJ

Nr.____/2019

PËR ORGANIZIMIN DHE FUNKSIONIMIN E POLICISË GJYQËSORE

Në mbështetje të neneve, 78, 81, pika 1, dhe 83, pika 1, të Kushtetutës, me propozimin e një deputeti,

K U V E N D I

I REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË

V E N D O S I:

KREU I DISPOZITA TË PËRGJTHSHME

Neni 1

Objekti

Ky ligj përcakton rregullat dhe parimet e përgjithshme në lidhje me:

- a) organizimin dhe funksionimin e shërbimeve dhe seksioneve të Policisë Gjyqësore;
- b) veprimtarinë e tyre hetimore;
- c) statusin e oficerëve të Policisë Gjyqësore;
- ç) raportet me prokurorinë dhe me institucionet shtetërore ku bëjnë pjesë.

Neni 2

Përkufizimet

Në këtë ligj termat e mëposhtëm kanë këto kuptime:

1. “Oficer i Policisë Gjyqësore” është një person i emëruar, sipas këtij ligji, në një shërbim ose seksion të Policisë Gjyqësore ose në shërbime të Policisë Gjyqësore të Byrosë Kombëtare të Hetimit.
2. “Agjent i Policisë Gjyqësore” është një punonjës i Policisë së Shtetit, Policisë Ushtarake dhe çdo shërbimi tjetër policor, që ligji i njuh një cilësi të tillë.
3. ”Shërbim i Policisë Gjyqësore” është një strukturë e veçantë në Policinë e Shtetit, Policinë Ushtarake dhe në institucione të tjera shtetërore, të cilave ligji i posaçëm u njuh funksionet e Policisë Gjyqësore, sipas Kodit të Procedurës Penale dhe parashikimeve të këtij ligji.
4. “Seksion i Policisë Gjyqësore” është një strukturë e veçantë në prokuroritë pranë gjykatave të shkallës së parë të juridiksionit të përgjithshëm dhe në Prokurorinë e Përgjithshme.
5. ”Papajtueshmëri etike“ është një situatë kur oficeri i Policisë Gjyqësore pengohet të ushtrojë me objektivitet funksionet e tij në një zyrë të caktuar, nga lidhjet e papërshtatshme shoqërore ose nga konflikti i interesit.
6. “Strukturë hetimore” është pjesë e strukturës së përgjithshme të Policisë së Shtetit, e përbërë nga oficerë të shërbimeve policore, e ngarkuar posaçërisht me kryerjen e hetimeve.
7. “Ngritja në detyrë” konsiderohet lëvizja e oficerit të Policisë Gjyqësore të seksionit nga një prokurori pranë gjykatave të shkallës së parë të juridiksionit të përgjithshëm në Prokurorinë e Përgjithshme .
8. “Komandimi” është lëvizja e përkohshme e oficerëve të Policisë Gjyqësore të seksioneve apo shërbimeve për nevoja organizative ose për nevoja të hetimeve për një çështje të caktuar.

9. “Transferimi” është caktimi i oficerit të Policisë Gjyqësore nga një seksion apo shërbim i Policisë Gjyqësore në një seksion apo shërbim të të njëjtit nivel.

Neni 3

Parimet në ushtrimin e veprimtarisë të Policisë Gjyqësore

1. Policia Gjyqësore, gjatë ushtrimit të veprimtarisë së saj, udhëhiqet nga këto parime:
 - a) ligjshmëria;
 - b) barazia dhe mosdiskriminimi;
 - c) objektiviteti dhe paanshmëria;
 - ç) profesionalizmi dhe ndershmëria në ushtrimin e detyrave;
 - d) shmangia e konfliktit të interesit;
 - dh) ruajtja e konfidencialitetit dhe sekretit hetimor.
 - e) respektimi i lirive dhe të drejtave të njeriut.

Neni 4

Subjektet që ushtrojnë funksionet e Policisë Gjyqësore

Funksionet e policisë gjyqësore ushtrohen nga:

- a) oficerët e policisë gjyqësore në seksionet pranë prokurorive të juridiksionit të përgjithshëm,
- b) punonjësit e Policisë së Shtetit, të cilët janë pjesë e strukturës hetimore,
- c) punonjësit e Byrosë Kombëtare të Hetimit, të cilët kanë statusin e oficerëve të Policisë Gjyqësore sipas legjislacionit në fuqi për organizimin dhe funksionimin e institucioneve për të luftuar korrupsionin dhe krimin e organizuar,
- ç) punonjësit e shërbimeve të tjera policore dhe të institucioneve shtetërore të cilëve me ligj u njihen funksionet e Policisë Gjyqësore.

KREU II

VARËSIA DHE USHTRIMI I FUNKSIONEVE

Neni 5

Funksionet e Policisë Gjyqësore

1. Policia Gjyqësore kryen këto funksione:
 - a) merr dijeni për veprat penale, me iniciativën e vet ose mbi kallëzim apo ankim;
 - b) parandalon ose pengon pasojat e mëtejshme që rrjedhin nga vepra penale;
 - c) kërkon autorët e veprave penale;
 - ç) kryen veprimet e nevojshme për të siguruar burimet e provës dhe për të grumbulluar gjithçka që i shërben zbatimit të ligjit penal;
 - d) kryen çdo hetim dhe veprim të urdhëruar ose të deleguar nga organi procedues;
 - dh) kryen veprime procedurale për ekzekutimin e vendimeve gjyqësore penale;
 - e) kryen veprime në kuadër të marrëdhënieve juridiksionale penale me autoritetet e huaja;
 - ë) kryen veprime në zbatim të legjislacionit për parandalimin dhe goditjen e krimit të organizuar dhe trafikimit nëpërmjet masave parandaluese kundër pasurisë;
 - f) kryen çdo detyrë të tjetër të parashikuar me ligj;
2. Policia Gjyqësore dokumenton kryerjen e veprimeve procedurale të saj në përputhje me rregullat e Kodit të Procedurës Penale.

Neni 6

Veprimtaria me iniciativë në raste të veçanta

Oficerët dhe agentët e Policisë Gjyqësore, si dhe çdo punonjës i Policisë së Shtetit kanë të drejtë të kryejnë veprime kur lind nevoja e ruajtjes së gjurmëve të veprës penale ose të vendngjarjes, në përputhje me dispozitat e Kodit të Procedurës Penale, duke njoftuar menjëherë, sipas rastit, shërbimin ose seksionin kompetent të Policisë Gjyqësore dhe prokurorinë kompetente.

Neni 7

Mbikëqyrja dhe varësia funksionale e Policisë Gjyqësore

1. Policia Gjyqësore i ushtron funksionet e saj për hetimin e çështjes konkrete, nën varësinë e prokurorit dhe drejtohet e kontrollohet prej tij.
2. Policia Gjyqësore zbaton urdhrat dhe udhëzimet e prokurorit për përcaktimin e çështjeve që duhen hetuar me përparësi, e veprimeve konkrete që duhen kryer, si dhe për kohëzgjatjen e nevojshme të hetimeve.
3. Gjatë shqyrtimit gjyqësor të çështjes, Policia Gjyqësore kryen të gjitha veprimet e urdhëruara nga gjykata ose prokurori.
4. Prokurori dhe gjykata disponojnë drejtpërsëdrejti oficerët e seksioneve dhe mund të delegojnë ose urdhërojnë oficerët e shërbimeve për kryerjen e veprimeve të posaçme.
5. Drejtuesi i prokurorisë jep urdhra të detyrueshëm për Policinë Gjyqësore që ka në juridiksion lidhur me ushtrimin e funksioneve në zbatim të ligjit.
6. Prokurori i Përgjithshëm nxjerr udhëzime të përgjithshme me karakter detyrues për oficerët e Policisë Gjyqësore dhe për koordinimin e veprimtarisë së prokurorëve në përputhje me dispozitat e Kodit të Procedurës Penale, legjislacionit në fuqi për organizimin dhe funksionimit të prokurorisë dhe këtë ligj, si dhe mbikëqyr zbatimin e tyre.

Neni 8

Ruajtja e sekretit të hetimeve

1. Policia Gjyqësore zbaton rregullat e legjislacionit në fuqi për ndalimin e publikimit të akteve që dokumentojnë veprimet procedurale, si dhe çdo informacioni tjetër që rrjedh prej tyre.

2. Policisë Gjyqësore i ndalohet, posaçërisht, të publikojë ose të përhapë fotot dhe gjenealitetet e të miturve, viktimave, si dhe çdo të dhënë tjetër që cenon liritë dhe të drejtat kushtetuese të personit.
3. Referimi i burimeve të provave dhe të dhënave të tjera të siguruara gjatë hetimeve paraprake kryhet vetëm para prokurorit që drejton dhe kontrollon hetimet.

KREU III

KOMISIONI I POLICISË GJYQËSORE

Neni 9

Komisioni i Policisë Gjyqësore

1. Komisioni i Policisë Gjyqësore është organ kolegjal i përbërë nga 5 anëtarë. Përbërja e Komisionit përcaktohet si më poshtë:
 - a) një anëtar prokuror, nga seksioni i prokurorëve në Prokurorinë e Përgjithshme, i caktuar nga Prokurori i Përgjithshëm;
 - b) një anëtar oficer i Policisë Gjyqësore i seksionit të Prokurorisë, i cili të ketë punuar jo më pak se pesë vjet si oficer i Policisë Gjyqësore, i caktuar nga Prokurori i Përgjithshëm;
 - c) një anëtar oficer i shërbimeve në Policinë e Shtetit, pjesë e strukturës hetimore, i cili të ketë punuar jo më pak se pesë vjet si oficer i Policisë Gjyqësore, i caktuar nga Drejtori i Përgjithshëm i Policisë së Shtetit;
 - ç) një anëtar, drejtues i strukturës hetimore të shërbimeve të Policisë së Shtetit me gradën jo më të ulët se drejtues;
 - d) një anëtar i shërbimeve e tjera të Policisë Gjyqësore të institucioneve shtetërore, i cili caktohet me rrotacion, çdo 2 vjet, nga Drejtori i Përgjithshëm i Tatimeve dhe/ose nga Drejtori i Përgjithshëm i Doganave.
2. Kryetari i Komisionit i Policisë Gjyqësore është anëtari prokuror. Ai e ushtron detyrën me kohë të plotë.

3. Kryetari dhe anëtarët e Komisionit të Policisë Gjyqësore kanë mandat 2-vjeçar me të drejtë rizgjedhje vetëm një herë. Anëtarët e Komisionit shërbejnë me kohë të pjesshme.
4. Në rastet kur për shkak të papajtueshmërisë ose konfliktit të interesit të anëtarit të Komisionit të Policisë Gjyqësore, nuk arrihet kuorumi i nevojshëm për zhvillimin e mbledhjes, Kryetari i Komisionit u kërkon institucioneve të emërtesës zëvendësimin e tij, sipas kritereve të përcaktuara në shkronjat “b”, “c”, “ç” dhe “d”, të pikës 1, të këtij neni.
5. Anëtarët e Komisionit të Policisë Gjyqësore shpërblehen për pjesëmarrje në mbledhje. Masa e shpërblimit të anëtarëve caktohet me vendim të Këshillit të Ministrave.

Neni 10

Kompetencat e Komisionit të Policisë Gjyqësore

1. Komisioni i Policisë Gjyqësore ushtron kompetencat e mëposhtme:
 - a) përcakton numrin e përgjithshëm të oficerëve të Policisë Gjyqësore të seksioneve dhe shërbimeve, në bashkëpunim me Prokurorin e Përgjithshëm dhe ministrat përgjegjës, të cilët kanë në varësi shërbimet e Policisë Gjyqësore;
 - b) emëron, ngre në detyrë, transferon dhe komandon oficerët e Policisë Gjyqësore të seksioneve, me propozim të Prokurorit të Përgjithshëm;
 - c) miraton transferimin dhe komandimin e oficerëve të Policisë Gjyqësore të shërbimeve, me propozim të titullarit të institucionit shtetëror ku ata bëjnë pjesë;
 - ç) shqyrton kërkesat për procedim disiplinor ndaj oficerëve të Policisë Gjyqësore, sipas parashikimeve të këtij ligji;
 - d) vlerëson rezultatet e punës dhe integritetin e oficerëve të Policisë Gjyqësore;
- dh) përcakton rregullat për organizimin e një trajnimi fillestar për hetimin,

sipas neneve 16 dhe 17, të këtij ligji, në bashkëpunim me Prokurorin e Përgjithshëm, Akademinë e Sigurisë ose institucionet publike arsimore, të ngarkuara me ligj për trajnim profesional;

- e) vlerëson nevojat për trajnim dhe planifikon trajnimet e oficerëve dhe agjenteve të Policisë Gjyqësore në bashkëpunim me Prokurorinë e Përgjithshme dhe Akademinë e Sigurisë dhe institucionet publike arsimore, të ngarkuara me ligj për trajnimin profesional.

2.Kompetencat e Komisionit, të parashikuara në pikën 1, të këtij neni, nuk ushtrohen ndaj punonjësve të Byrosë Kombëtare të Hetimit që kanë statusin e oficerëve të Policisë Gjyqësore.

Neni 11

Organizimi dhe funksionimi i Komisionit të Policisë Gjyqësore

1. Kryetari thërret mbledhjen e parë të Komisionit brenda 30 ditëve nga caktimi i anëtarëve.
2. Mbledhjet e Komisionit janë të vlefshme kur janë të pranishëm 3 (tre) anëtarë.
3. Mbledhjet e Komisionit zhvillohen në ambientet e Prokurorisë së Përgjithshme.
4. Komisioni vendos me shumicë votash të anëtarëve të pranishëm me votim të hapur. Kur votat ndahen në mënyrë të barabartë, vota e kryetarit është përcaktuese.
5. Kryetari i Komisionit, në bashkëpunim me Prokurorin e Përgjithshëm, cakton nga radhët e personelit administrativ të Prokurorisë së Përgjithshme numrin e nevojshëm të punonjësve administrativë, që ushtrojnë detyrat e Sekretariatit Teknik të Komisionit.
6. Rregulla të detajuara për organizimin dhe funksionimin e Komisionit të Policisë Gjyqësore, përbërja dhe detyrat e Sekretariatit Teknik, përcaktohen në rregulloren e brendshme që miratohet nga Komisioni.

KREU IV
ORGANIZIMI I POLICISË GJYQËSORE

Neni 12

Shërbimet e Policisë Gjyqësore

1. Shërbimet e Policisë Gjyqësore organizohen në Policinë e Shtetit, në shërbimet e tjera policore dhe institucione shtetërore, të cilave me ligj u njihen funksione të Policisë Gjyqësore.
2. Shërbimet e Policisë Gjyqësore në Policinë e Shtetit organizohen në strukturën hetimore, sipas përcaktimeve në legjislacionin në fuqi për Policinë e Shtetit dhe përcaktimeve në këtë ligj.
3. Shërbimet e tjera të Policisë Gjyqësore ruajnë organizimin dhe hierarkinë, sipas strukturës së institucionit shtetëror ku bëjnë pjesë.
4. Byroja Kombëtare e Hetimit përbëhet nga hetuesit dhe oficerët e shërbimeve të Policisë Gjyqësore. Ajo organizohet dhe funksionon sipas përcaktimeve në legjislacionin në fuqi për organizimin dhe funksionimin e institucioneve për të luftuar korrupsionin dhe krimin e organizuar.
5. Oficerët dhe agjentët e Policisë Gjyqësore të shërbimeve përgjigjen për kryerjen e hetimeve në përputhje me dispozitat e Kodit të Procedurës Penale.

Neni 13

Seksionet e Policisë Gjyqësore

1. Seksionet e Policisë Gjyqësore krijohen në prokuroritë pranë gjykatës së shkallës së parë të juridiksionit të përgjithshëm dhe në Prokurorinë e Përgjithshme.

2. Seksionet e Policisë Gjyqësore përbëhen nga juristë dhe specialistë të fushave të ndryshme të ekspertizës, të cilët kryejnë funksionet e oficerit të Policisë Gjyqësore.
3. Specialistët oficerë të Policisë Gjyqësore kryejnë hetime të posaçme, bazuar në kualifikimin profesional ose trajnimin në fusha, të cilat kërkojnë specializim të veçantë.
4. Specialistët oficerë të Policisë Gjyqësore përbëjnë jo më shumë se 25 % të numrit të përgjithshëm të oficerëve të Policisë Gjyqësore të seksioneve.

Neni 14

Organizimi i shërbimeve të Policisë Gjyqësore

1. Oficerët e Policisë Gjyqësore në Policinë e Shtetit, në shërbimet e tjera policore ose në institucione shtetërore, të cilëve ligji i posaçëm u ka njohur funksionet e Policisë Gjyqësore, ushtrojnë funksionet e tyre në çdo njësi territoriale ku veprojnë prokuroritë e shkallës së parë të juridiksionit të përgjithshëm.
2. Titullari i institucionit ku bën pjesë shërbimi i Policisë Gjyqësore ka detyrimin dhe merr masa për ngritjen e shërbimit përkatës të Policisë Gjyqësore pranë çdo prokurorie të shkallës të parë të juridiksionit të përgjithshëm, sipas pikës 1, të këtij neni, dhe pajisjen e tij me personelin, infrastrukturën dhe mjetet e nevojshme për përmbushjen e detyrave.
3. Byroja Kombëtare e Hetimit ushton funksionet, sipas parashikimit në legjislacionin në fuqi për organizimin dhe funksionim e institucioneve për të luftuar korrupsionin dhe krimin e organizuar.

Neni 15

Organizimi i seksioneve të Policisë Gjyqësore

1. Seksionet e Policisë Gjyqësore organizohen në përputhje me strukturën e prokurorive të shkallës së parë të juridiksionit të përgjithshëm dhe në

Prokurorinë e Përgjithshme, sipas legjislacionit në fuqi për organizimin dhe funksionimin e Prokurorisë.

2. Drejtuesi i prokurorisë drejton, bashkërendon dhe mbikëqyr veprimtarinë e oficerëve të Policisë Gjyqësore të seksionit, në përputhje me kërkesat e prokurorëve dhe gjykatës.

Neni 16

Kriteret e përzgjedhjes të oficerit të shërbimeve të Policisë Gjyqësore

1. Përveç kriterëve të parashikuar nga ligji i posaçëm, mund të emërohet oficer i Policisë Gjyqësore në shërbimet e Policisë Gjyqësore, personi që përmbush kriteret e mëposhtme:
 - a) të ketë 5 vjet përvojë pune në institucionin e emërtesës;
 - b) të ketë përfunduar trajnimin fillestar për hetimin;
 - c) të mos jetë dënuar me vendim gjyqësor të formës së prerë për kryerjen e një veprë penale, të mos jetë në hetim penal apo gjykim për një vepër penale;
 - ç) të mos ketë marrë masë disiplinore dhe ndaj tij të mos ketë filluar procedim disiplinor;
 - d) të ketë integritet.
2. Parashikimi i pikës 1, shkronjat “a” dhe “b”, të këtij neni, nuk zbatohet për përzgjedhjen e oficerëve të Policisë Gjyqësore në Policinë e Shtetit.

Neni 17

Kriteret e përzgjedhjes të oficerit të Policisë Gjyqësore të seksionit

Personi që emërohet oficer i Policisë Gjyqësore në seksione duhet të përmbushë kriteret e mëposhtme:

- a) të jetë shtetas shqiptar;
- b) të ketë përfunduar studimet e universitare në një nga institucionet e arsimit të lartë, sipas legjislacionit në fuqi për arsimin e lartë;
- c) të ketë pesë vjet përvojë pune:

- i. si jurist në institucionet publike, private ose në profesione të lira; ose
 - ii. në fushën e specialitetit të kërkuar; ose
 - iii. si oficer i Policisë Gjyqësore në shërbimet e Policisë Gjyqësore;
- ç) të ketë përfunduar trajnimin fillestar për hetimin;
- d) të mos jetë dënuar me vendim gjyqësor të formës së prerë për kryerjen e një vepre penale dhe të mos jetë në hetim penal apo gjykim për një vepër penale;
- dh) të mos ketë masë disiplinore dhe ndaj tij të mos ketë filluar procedim disiplinor;
- e) të ketë integritet.

Neni 18

Procedura e përzgjedhjes për oficerët e Policisë Gjyqësore

1. Përzgjedhja e oficerëve të Policisë Gjyqësore të seksioneve realizohet nëpërmjet një procesi të hapur dhe transparent konkurrimi.
2. Në përfundim të procedurës së parashikuar në pikën 1, të këtij neni, Prokurori i Përgjithshëm, pasi merr mendimin e drejtuesit të prokurorisë përkatëse, përzgjedh kandidaturat më të përshtatshme dhe ia propozon Komisionit të Policisë Gjyqësore për emërim.
3. Rregulla më të hollësishme për organizimin e procedurës së konkurrimit dhe emërimit të oficerëve të Policisë Gjyqësore të seksioneve përcaktohen me propozim të Komisionit dhe miratim të Prokurorit të Përgjithshëm.
4. Përzgjedhja për shërbimet e Policisë Gjyqësore në Policinë e Shtetit dhe në institucione shtetërore, të cilave ligji i posaçëm u njeh funksionet e Policisë Gjyqësore, bëhet sipas përcaktimeve në ligjet e posaçme dhe të kriterëve të këtij ligj.

Neni 19

Heqja dore dhe zëvendësimi

Për heqjen dorë dhe zëvendësimin e oficerit të Policisë Gjyqësore zbatohen dispozita e Kodit të Procedurës Penale.

Neni 20

Ngritja në detyrë

Me propozimin e Prokurorit të Përgjithshëm, për oficerët e Policisë Gjyqësore të seksioneve, të cilët kanë përvojë punë mbi 7 vjet, Komisioni i Policisë Gjyqësore, pasi vlerëson rezultatet në punë dhe integritetin e tyre, vendos ngritjen në detyrë.

Neni 21

Komandimi

1. Për nevojat e kryerjes së hetimeve për një çështje të caktuar ose për nevoja organizative, me propozimin e Prokurorit të Përgjithshëm ose të titullarit të institucionit shtetëror përkatës, Komisioni i Policisë Gjyqësore mund të komandojë oficerët e Policisë Gjyqësore nga një seksion apo shërbim në një seksion apo shërbim tjetër të njëjtit nivel.
2. Komandimi i oficerëve të Policisë Gjyqësore për nevoja organizative bëhet për periudha 3-mujore dhe nuk mund të kalojë më shumë se 6 muaj brenda një viti kalendarik.
3. Në rastet kur komandimi është bërë për nevojat e kryerjes së hetimit të një çështjeje konkrete, afati i komandimit është i lidhur me përfundimin e hetimeve paraprake.
4. Me përfundimin e periudhës së komandimit, oficeri i Policisë Gjyqësore të seksionit apo shërbimeve kthehet në pozicionin e tij të mëparshëm.

Neni 22

Transferimi

1. Transferimi mund të bëhet në një pozicion të lirë të përhershëm:
 - a) për shkak të ndryshimeve strukturore të seksioneve apo shërbimeve;
 - b) me kërkesë të oficerit të Policisë Gjyqësore drejtuar, sipas rastit, Prokurorit të Përgjithshëm ose titullarit të emërtesës;
 - c) kur ekziston një situatë reale rreziku ndaj jetës dhe shëndetit të oficerit të Policisë Gjyqësore ose të familjes së tij;
 - d) për të shmangur situatën e papajtueshmërisë së vazhdueshme etike dhe kur çdo masë tjetër ka rezultuar joefektive.

2. Transferimi për shkak të papajtueshmërisë etike ka përparësi ndaj lëvizjeve paralele.
3. Transferimi i oficerit të Policisë Gjyqësore propozohet nga Prokurori i Përgjithshëm ose nga titullari i institucionit shtetëror përkatës, sipas rastit.
4. Komisioni i Policisë Gjyqësore, pasi verifikon përmbushjen e kriterëve të pikës 1, të këtij neni, jo më vonë se 10 ditë nga marrja e propozimit, vendos mbi pranimin ose mospranimin e tij. Në rastet kur transferimi ndikon në ecurinë e hetimeve paraprake, Komisioni i Policisë Gjyqësore mund të vendosë shtyrjen e tij në një kohë të përshtatshme.
5. Vendimi i Komisionit i njoftohet menjëherë propozuesit.

Neni 23

Shkarkimi dhe lirimi

1. Oficeri i Policisë Gjyqësore lirohet nga detyra në rastet kur:
 - a) jep dorëheqjen;
 - b) mbush moshën e pensionit;
 - c) bëhet i paaftë përgjithmonë për të kryer detyrën, për shkak të gjendjes shëndetësore.
2. Oficeri i Policisë Gjyqësore shkarkohet nga detyra kur:
 - a) dënohet me vendim gjyqësor të formës të prerë për kryerjen e një vepre penale;
 - b) ndaj tij merret masa disiplinore “largim nga detyra”.

KREU V

VEPRIMTARIA HETIMORE E POLICISË GJYQËSORE

Neni 24

Kryerja e veprimeve hetimore nga shërbimet e Policisë Gjyqësore

1. Prokurori urdhëron shërbimet e Policisë Gjyqësore për të kryer hetimet paraprake në të gjitha rastet kur procedimi penal është regjistruar në bazë të referimit të veprës penale prej tyre.

2. Në raste të veçanta, për të garantuar objektivitetin e hetimit, drejtuesi i prokurorisë, me kërkesë të arsyetuar të prokurorit, mund të urdhërojë oficerët e shërbimeve të tjera ose seksioneve të Policisë Gjyqësore për kryerjen e hetimeve.
3. Prokurori mund të urdhërojë shërbimet e Policisë Gjyqësore për të kryer hetime paraprake edhe në rastet kur njoftimi ose referimi i veprës penale është bërë nga burime të tjera.

Neni 25

Kryerja e veprimeve hetimore nga seksionet e Policisë Gjyqësore

Seksionet e Policisë Gjyqësore kryejnë hetime paraprake në rastet kur:

- a) kallëzimi, me shkrim ose me gojë, bëhet drejtpërsëdrejti në prokurori;
- b) marrja dijeni për veprën penale dhe referimi i saj kryhen nga oficerët e seksionit;
- c) institucioni shtetëror që ka kallëzuar veprën penale nuk ka shërbime të Policisë Gjyqësore;
- ç) kur hetimi fillohet kryesisht nga prokurori;
- d) prokurori çmon se çështja ka natyrë të posaçme ose kërkon hetime komplekse apo të specializuara, që nuk mund të kryhen nga shërbimet e Policisë Gjyqësore.

Neni 26

Kryerja e veprimeve hetimore nga seksionet dhe shërbimet e Policisë Gjyqësore

1. Në varësi të natyrës dhe kompleksitetit të çështjes, prokurori mund të urdhërojë kryerjen e veprimeve hetimore të përbashkëta nga oficerë të Policisë Gjyqësore të shërbimeve dhe të seksioneve.
2. Urdhëri i prokurorit i njoftohet shërbimit përkatës të Policisë Gjyqësore, i cili merr masa për ekzekutimin e tij.

KREU VI TRAJNIMI DHE VLERËSIMI I REZULTATEVE NË PUNË

Neni 27

Trajnim fillestar për pranimin në Policinë Gjyqësore

Akademia e Sigurisë ose institucionet publike arsimore, të ngarkuara me ligj për trajnim profesional, në bashkëpunim me Komisionin e Policisë Gjyqësore dhe Prokurorin e Përgjithshëm, kryejnë trajnimin fillestar hetimi, sipas parashikimeve të neneve 16 dhe 17 të këtij ligji.

Neni 28

Trajnimi vazhdues i oficerëve të Policisë Gjyqësore

1. Oficerët e Policisë Gjyqësore i nënshtrohen trajnimit vazhdues pranë institucioneve publike arsimore, të ngarkuara me ligj për kryerjen e trajnimit profesional.
2. Periudha e trajnimit vazhdues duhet të jetë në përputhje me programin përkatës të miratuar nga Komisioni i Policisë Gjyqësore.
3. Pjesëmarrja në trajnimin vazhdues është e detyrueshme.
4. Rregulla më të hollësishme për organizimin e trajnimit, hartimin e programeve të trajnimit, pjesëmarrjen në to, si dhe për shpenzimet e trajnimeve përcaktohen me marrëveshje midis Komisionit të Policisë Gjyqësore, Prokurorit të Përgjithshëm, titullarit të institucionit ku oficeri i Policisë Gjyqësore ushtron funksionet dhe drejtuesit të institucionit publik arsimor.

Neni 29

Vlerësimi i rezultateve

1. Oficerët e Policisë Gjyqësore i nënshtrohen një vlerësimi periodik.
2. Çdo vit Drejtuesi i Prokurorisë, pas marrjes së mendimit me shkrim nga prokurorët, i paraqet Komisionit një vlerësim të rezultateve të punës për oficerët e Policisë Gjyqësore.

3. Komisioni i Policisë Gjyqësore, mbi bazën e rezultateve të paraqitura, bën klasifikimin vlerësimit të oficerëve të Policisë Gjyqësore, sipas përcaktimeve: “I paaftë”, “Mjaftueshëm”, “Mirë” dhe “Shumë mirë”.
4. Vlerësimi “I paaftë” përbën shkak për fillimin e procedurës disiplinore për shkarkimin nga detyra.
5. Aktet e vlerësimit, të plotësuara në zbatim të këtij neni, bëhen pjesë e dosjes personale të oficerit të Policisë Gjyqësore.
6. Në rastet e ngritjes në detyrë, oficeri i Policisë Gjyqësore duhet të ketë vlerësimet e 3 viteve të fundit “shumë mirë”.
7. Rregulla të hollësishme për mënyrën e vlerësimit të rezultateve vetjake gjatë ushtrimit të funksioneve të oficerëve të Policisë Gjyqësore përcaktohen nga Komisioni i Policisë Gjyqësore.

KREU VII

TRAJTIMI FINANCIAR I POLICISË GJYQËSORE

Neni 30

Paga dhe shpërblime të oficerëve të Policisë Gjyqësore

1. Paga e oficerit të Policisë Gjyqësore, në seksione të prokurorive pranë gjykatave të shkallës së parë të juridiksionit të përgjithshëm dhe në Prokurorinë e Përgjithshme është e barabartë me 60 për qind të pagës bruto fillestare të prokurorit që ushtron funksionet pranë tyre, sipas përcaktimeve në legjislacionin në fuqi për statusin e gjyqtarit dhe prokurorit.
2. Pas 5 vjetësh në shërbim në seksionin e Policisë Gjyqësore, për çdo vit vjetërsi, deri në 25 vjet shërbim, kjo pagë shtohet me 2 për qind në vit, e llogaritur sipas përcaktimeve në legjislacionin në fuqi për statusin e gjyqtarit dhe prokurorit .
3. Oficerët e Policisë Gjyqësore në strukturën hetimore në Policinë e Shtetit përfitojnë shtesë page deri në 10 % të pagës bazë për gradën përkatëse të punonjësit të Policisë së Shtetit.

4. Paga e oficerit të Policisë Gjyqësore të Byrosë Kombëtare të Hetimit është 20 % më e lartë se paga e oficerit të Policisë Gjyqësore të seksioneve, e llogaritur mbi pagën bruto fillestare oficerit të Policisë Gjyqësore të seksionit.
5. Oficerët e Policisë Gjyqësore të seksioneve, me propozim të Drejtuesit të Prokurorisë dhe me miratim të Prokurorit të Përgjithshëm, mund të përfitojnë shpërblime për merita profesionale. Kriteret për shpërblim për merita të veçanta për oficerët e Policisë Gjyqësore të seksioneve përcaktohen me udhëzim të Prokurorit të Përgjithshëm, pasi të ketë marrë mendimin e Komisionit të Policisë Gjyqësore dhe në përputhje me legjislacionin në fuqi.

Neni 31

Përfitime të tjera të oficerit të Policisë Gjyqësore

1. Oficerët e Policisë Gjyqësore të seksioneve përfitojnë leje të pagueshme vjetore prej 30 ditësh kalendarike. Leja vjetore, si rregull, kryhet në muajin gusht. Oficeri i Policisë Gjyqësore, i ngarkuar me kryerjen e detyrave të ngutshme në muajin gusht, lejen vjetore e kryen në një periudhë tjetër, duke përfituar pesë ditë shtesë.
2. Për nevoja të kualifikimeve dhe specializimeve profesionale, oficeri i Policisë Gjyqësore ka të drejtë të kërkojë leje të papagueshme dhe ruajtjen e vendit të punës deri në një vit.
3. Oficerët e Policisë Gjyqësore të seksioneve, shërbimeve në Policinë e Shtetit, si dhe të Byrosë Kombëtare të Hetimit pajisen me armë zjarri, sipas legjislacionit në fuqi për përdorimin e armëve të zjarrit.

KREU VIII
PËRGJEGJËSIA DISIPLINORE E OFICERËVE TË POLICISË
GJYQËSORE

Neni 32

Rregulla të përgjithshme

1. Gjatë ushtrimit të funksioneve të tij, oficeri i Policisë Gjyqësore i nënshtrohet përgjegjësisë disiplinore në rastet e parashikuara në këtë ligj.
2. Procedimi disiplinor respekton parimet e ligjshmërisë, objektivitetit, mbrojtjes së të drejtave dhe kontradiktoritetit, në përputhje me normat dhe garancitë e procesit të rregullt ligjor.
3. Ka konkurrim të shkeljeve disiplinore në rastet kur oficeri i Policisë Gjyqësore kryen dy ose më shumë shkelje dhe kur vendimi që ka caktuar masën disiplinore për njërën prej tyre nuk ka marrë formë të prerë. Në rastin e konkurrimit të shkeljeve disiplinore jepet një masë e vetme dhe kur shkeljet e konstatuara sanksionohen me masa të ndryshme disiplinore, jepet masa më e rëndë.
4. Në caktimin e masës disiplinore mbahet parasysh rëndësia e faktit, forma e fajit, përsëritja, rrethanat lehtësuese dhe rënduese.
5. Procedimi disiplinor ka karakter konfidencial. Ndalohet publikimi apo përhapja e të dhënave derisa subjekti i proceduar të ketë marrë dijeni për to.
6. Në rastet kur shkelja disiplinore kryhet nga agjenti i Policisë Gjyqësore, prokurori i kërkon institucionit të emërtesës fillimin e procedimit disiplinor.

Neni 33

Shkeljet disiplinore

1. Shkeljet e disiplinës së oficerëve të Policisë Gjyqësore ndahen në:
 - a) të lehta;
 - b) të rënda;
 - c) shumë të rënda.

2. Janë shkelje të lehta aktet dhe sjelljet e mëposhtme:
 - a) veprimet dhe mosveprimet e oficerëve të Policisë Gjyqësore, të cilat passjellin zvarritje të proceseve hetimore;
 - b) mungesa e pajustificuar në punë deri në 3 ditë;
 - c) shkelja e rregullave të etikës.
3. Janë shkelje të rënda aktet dhe sjelljet e mëposhtme:
 - a) zvarritja e pajustificuar dhe e përsëritur e veprimeve të oficerëve të Policisë Gjyqësore gjatë ushtrimit të funksioneve të parashikuara me ligj;
 - b) braktisja e punës ose mungesa e pajustificuar dhe e vijueshme për më shumë se 3 ditë;
 - c) thyerja e disiplinës në punë, në mënyrë të përsëritur dhe pas paralajmërimit të dhënë me shkrim nga eprori;
 - ç) mosinformimi i prokurorit për ecurinë e hetimeve nga oficeri drejtues, që ka për detyrë të informojë kryesisht;
 - d) fakte dhe sjellje të tjera që diskreditojnë rëndë pozitën dhe figurën e punonjësit të Policisë Gjyqësore.
4. Janë shkelje shumë të rënda aktet e poshtëshënuara:
 - a) raportimi i të dhënave për hetimin jashtë zyrës së prokurorit;
 - b) paraqitja e të dhënave dhe akteve që lidhen me kryerjen e një vepre penale, në tejkalim të afateve dhe procedurave të parashikuara në Kodin e Procedurës Penale;
 - c) moskryerja, kryerja me vonesë ose ekzekutimi i pjesshëm i një urdhri të ligjshëm të gjykatës a prokurorit, që lidhet me ushtrimin e funksioneve të Policisë Gjyqësore;
 - d) kryerja e veprimeve dhe mosveprimeve të tjera në kundërshtim me dispozitat urdhëruese apo ndaluese të Kodit të Procedurës Penale, me pasoja për hetimin e çështjes.

Neni 34 **Masat disiplinore**

1. Masat disiplinore ndaj oficerëve të Policisë Gjyqësore janë:
 - a) vërejtje me shkrim;
 - b) vërejtje me paralajmërim;
 - c) ulje në detyrë me afat nga tre muaj gjer në një vit;

- ç) pezullim nga detyra deri në 6 muaj;
- d) largim nga detyra ose çdo masë tjetër e barasvlershme me të.

2. Për shkeljet e lehta, të parashikuara nga neni 33, i këtij ligji, jepen masat disiplinore të parashikuara nga shkronjat “a” dhe “b”, të pikës 1, të këtij neni.

3. Për shkeljet e rënda, të parashikuara nga neni 33, i këtij ligji, jepet masa disiplinore e parashikuar nga shkronja “c”, e pikës 1, të këtij neni.

4. Për shkeljet shumë të rënda, të parashikuara nga neni 33, i këtij ligji, jepen masat disiplinore të parashikuara nga shkronjat “ç” e “d”, të pikës 1, të këtij neni.

5. Masat disiplinore parashkruhen kur kanë kaluar:

- a) 1 vit nga data që është dhënë masa, sipas shkronjave “a” dhe “b”, të pikës 1, të këtij neni;
- b) 3 vjet nga data që ka përfunduar masa e dhënë sipas shkronjave “c” dhe “ç”, të pikës 1, të këtij neni.

6. Masat disiplinore të parashkruara hiqen nga dosja personale.

Neni 35

Subjekte që kanë të drejtën e fillimit të procedimi disiplinor

1. Procedimi disiplinor fillon brenda 6 muajve nga zbulimi i shkeljes, por jo më vonë se tre vjet nga kryerja e saj.
2. Të drejtën për të kërkuar fillimin e procedurës disiplinore e kanë subjektet e mëposhtme:
 - a) Prokurori i Përgjithshëm,
 - b) drejtuesi i prokurorisë;
 - c) prokurori i çështjes për çështjen për të cilën është kryer shkelja disiplinore;
 - ç) titullari i institucionit shtetëror, të cilit ligji i posaçëm i njeh funksionet e Policisë Gjyqësore.
3. Në kërkesën për fillimin e procedimit disiplinor përshkruhen në mënyrë të përmbledhur natyra e shkeljes, faktet për të cilat kërkohet të fillohet procedimi disiplinor. Kërkesa shoqërohet nga relacioni i procedimit disiplinor, i cili përmban të dhëna të detajuara për shkeljet e pretenduara disiplinore.

Neni 36

Procedura disiplinore

1. Komisioni i Policisë Gjyqësore, brenda 30 ditëve nga marrja e kërkesës nga subjektet e parashikuara në nenin 35, të këtij ligji, nxjerr urdhrin për fillimin e procedimit disiplinor, ku përshkruhen në mënyrë të përmblodhur natyra e shkeljes, faktet për të cilat duhet të fillohet procedimi disiplinor.
2. Urdhri për fillimin e procedimit disiplinor shoqërohet nga relacioni shpjegues, i cili përmban:
 - a) të dhëna të detajuara për shkeljet e përmendura në urdhrin për fillimin e procedimit disiplinor;
 - b) të dhëna të tjera, të administruara në dosjen personale të oficerit të Policisë Gjyqësore, që lidhen me vlerësimet e mëparshme, masat disiplinore të dhëna mbi personalitetin, si edhe çdo e dhënë tjetër që i shërben procedimit disiplinor.
3. Oficeri i Policisë Gjyqësore, ndaj të cilit ka filluar procedimi disiplinor, njoftohet me shkrim brenda 5 ditëve nga nxjerrja e urdhrin, sipas pikës 2, të këtij neni, për shkaqet, faktet dhe dispozitat e shkelura, si dhe për datën e zhvillimit të seancës për shqyrtimin e procedimit disiplinor.
4. Oficeri i Policisë Gjyqësore, ndaj të cilit ka filluar procedimi disiplinor, ka të drejtë:
 - a) të informohet në mënyrë të qartë dhe të detajuar për faktet, shkeljet dhe sanksionet që mund të vendosen;
 - b) të parashtrijë pretendime dhe kërkesa;
 - c) të njihet me dokumentet e procedimit disiplinor dhe të depozitojë prova;
 - ç) të asistohet nga një mbrojtës i zgjedhur prej tij;
 - d) të kërkojë thirrjen dhe dëgjimin e dëshmitarëve, si dhe të paraqesë të dhëna të tjera në mbrojtje të tij.

Neni 37

Shqyrtimi i shkeljes disiplinore

1. Shqyrtimi i shkeljes disiplinore të pretenduar fillon me verifikimin e paraqitjes së palëve, verifikimin e faktit nëse oficeri është njohur me objektin e procedimit disiplinor dhe provat kundër tij, parashtrimin hyrës të subjektit përkatës dhe kërkesën e tij për marrjen dhe shqyrtimin e provave.
2. Oficeri i Policisë Gjyqësore dhe mbrojtësi i tij kanë të drejtë të paraqesin kundërshtimet e tyre dhe të kërkojnë marrjen e provave të reja.

3. Nëse palët e çmojnë të nevojshme, mund të kërkojnë thirrjen dhe dëgjimin e dëshmitarëve për rrethanat e fakteve që lidhen me çështjen.
4. Komisioni, përpara marrjes së vendimit, verifikon edhe:
 - a) dokumentacionin e dosjes personale të oficerit;
 - b) praktikat dhe rastet e procedimeve të mëparshme;
 - c) praninë e faktorëve ose rrethanave lehtësuese dhe rënduese, duke përfshirë edhe rrethanat e kryerjes së shkeljes disiplinore, qëndrimin e oficerit ndaj shkeljes së kryer, pasojat e shkaktuara etj.;
 - ç) përvojën dhe rezultatet individuale në ushtrimin e detyrës.

Neni 38 **Marrja e vendimit**

1. Pas shqyrtimit të fakteve dhe vlerësimit të provave, Komisioni jep vendim për marrjen e masës disiplinore ose pushimin e procedimit.
2. Vendimi jepet me shkrim, i arsyetuar, në përputhje me Kodin e Procedurave Administrative.

Neni 39 **Ankimi**

Vendimi përfundimtar për masën disiplinore mund të ankimohet nga oficeri ose agjenti i Policisë Gjyqësore, ndaj të cilit është marrë masa, ose nga çdo subjekt që ka kërkuar fillimin e procedimit disiplinor në gjykatën administrative brenda afateve të parashikuara në legjislacionin në fuqi për organizimin dhe funksionimin e gjykatave administrative dhe gjykimin e mosmarrëveshjeve administrative.

KREU IX **DISPOZITAT KALIMTARE**

Neni 40 **Dispozita kalimtare**

1. Oficerët e seksioneve të Policisë Gjyqësore në prokuroritë e juridiksionit të përgjithshëm dhe në Prokurorinë e Përgjithshme, si dhe oficerët e Policisë

Gjyqësore të shërbimeve të tjera vazhdojnë të ushtrojnë funksionin e tyre edhe pas hyrjes në fuqi të këtij ligji.

2. Oficerët e seksionit të Policisë Gjyqësore në Prokurorinë për Krime të Rënda mbeten në detyrë deri në krijimin e Byrosë Kombëtare të Hetimit. Pas krijimit të Byrosë Kombëtare të Hetimit, Komisioni i Policisë Gjyqësore bën shpërndarjen e tyre në seksionet pranë prokurorive të juridiksionit të përgjithshëm.
3. Anëtarët e Komisionit caktohen brenda 30 ditëve nga hyrja në fuqi e këtij ligji.
4. Në ngritjen për herë të parë të Komisionit të Policisë Gjyqësore, anëtari, sipas përcaktimit në pikën 1, shkronja “d”, të nenit 9, të këtij ligji, të jetë përfaqësuesi i caktuar nga Drejtori i Përgjithshëm i Doganave.

Neni 41

Aktet nënligjore

1. Ngarkohet Këshilli i Ministrave që, brenda 3 muajve nga hyrja në fuqi e këtij ligji, të nxjerrë akte nënligjore në zbatim të pikës 5, të nenit 9, të këtij ligji.

2. Ngarkohet Komisioni i Policisë Gjyqësore që, brenda 3 muajve nga krijimi, të nxjerrë rregulloren e brendshme, sipas pikës 6, të nenit 11, të këtij ligji.

3. Ngarkohet Komisioni i Policisë Gjyqësore që, brenda 6 muajve nga krijimi i tij, të nxjerrë aktet nënligjore në zbatim të pikës 7, të nenit 29, të këtij ligji.

Neni 42

Shfuqizime

Ligji nr. 8677 datë 2.11.2000, “Për organizimin dhe funksionimin e Policisë Gjyqësore”, i ndryshuar, shfuqizohet me hyrjen në fuqi të këtij ligji.

Aktet nënligjore, të nxjerra në zbatim të ligjit nr. 8677, datë 2.11.2000, “Për organizimin dhe funksionimin e Policisë Gjyqësore”, të ndryshuar, mbeten në fuqi deri në miratimin e akteve të reja nënligjore, në zbatim të këtij ligji, për sa kohë nuk bien në kundërshtim me parashikimet e këtij ligji.

Neni 43
Hyrja në fuqi

Ky ligj hyn në fuqi 15 ditë pas botimit në Fletoren Zyrtare.

K R Y E T A R I

Gramoz RUÇI

Miratuar në datën _____ 2019

